

Vaksinimi kundër Covid-19 në Västra Götaland

Vaksinimi i popullatës kundër Covid-19 në Västra Götaland është i ndarë në katër etapa. Se sa shpejt do ju ofrohet mundësia për vaksinim varet nga sasia e vaksinave që do të kemi në dizpozicion. Informatat aktuale për vaksinimin gjinden në 1177.se dhe në faqën e internetit të Qendres suaj shëndetsore.

Vaksinimi kundër Covid-19 është falas. Shërbimi mjekësor nuk do të kërkoj që ju të paguani, të tregoni numër kontoje ose kode tjera gjatë vaksinimit.

Vaksinimi i grupeve që kanë prioritet

Më të moshuarit, personat e brishtë si dhe ata me disa lloje sëmundjesh do të vaksinohen të parët. Nëse ju i përkisni ndonjërit nga këto grupe do të vaksinoheni në Qendren shëndetsore ku jeni i listuar ose në ordinancën specialitike të cilës i përkisni. Personeli mjekësor që punon afër me pacientët mund të ketë nevojë të vaksinohet qysh në fillim. Mënyra se si ju do të kontaktoheni ndryshon varësisht se cilës Qendre shëndetsore ose ordinance i përkisni. Informatat gjinden në 1177.se dhe në faqën e internetit të Qendres suaj shëndetsore.

Vaksinimi i popullatës

Të gjithëve do ju ofrohet vaksinimi kundër Covid-19. Vaksinimi i popullatës së gjerë fillon pasi që të jenë vaksinuar grupet me prioritet. Më të moshuarit vaksinohen të parët. Kur të filloi vaksinimi i popullatës, do të ketë informata te duhura se si duhet të veproni për të kontaktuar dhe rezervuar kohë për vaksinim. Nëse nuk dini të lexoni suedisht mund të ju duhet ndihma e një personi tjetër për të bërë rezervimin e kohës për vaksinim në mënyrë digjitale. Ju gjithashtu mund të telefononi në ordinancën që bënë vaksinimin.

Vaksinimi do të bëhet në Qendrat shëndetsore, në spitale si dhe në ordinance private vaksinimi. Ju mund të zgjedhni se ku do të vaksinoheni. Ju gjithashtu mund të vaksinoheni edhe në një regjion tjetër. Informatat aktuale do të gjinden këtu në 1177.se dhe në faqën e internetit të [Qendres suaj mjekësore](#).

Nuk mund të zgjedhni llojin e vaksinës

Regjioni Västra Götaland posedon të gjitha llojet e vaksinave të aprovuara sikurse edhe regjionet tjera në Suedi. Ju nuk mund të zgjedhni se cilën vaksinë do ta pranoni. Për shumicën e vaksinave duhet të mirren dy doza me disa javë ndërmjet vaksinimeve, për të fituar mbrojtje të mirë.

Shërbimi i telefonatave me përkthyes

Regjioni Västra Götaland ka një shërbim përmes telefonit që informon për vaksinimin. Janë informatat e njëjta sikurse në 1177.se. Shërbimi është në gjuhët arabe, perse dhe somaleze. Aty nuk ju ndihmohet për rezervimin e kohës, si dhe nuk përgjigjen në çështje mjekësore.

Numri i telefonit: 010-473 94 30. Orari i punës: 07:00 – 16:00.

Arabisht: 011-473 00 22

Persisht: 011-473 00 23

Somalisht: 011-473 00 24

Lexo më shumë për ndarjen nëpër etapa në faqën e internetit të Agjencisë së shëndetit publik.

Tani ka filluar vaksinimi i popullatës.